

O R I O N sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E PERFORMANCËS

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

3

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

4

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

5 – 19

ORION sh.p.k.
(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	15,368,375	13,203,106
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	454,783,110	599,376,204
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	423,066	3,843,162
Inventarë	7	26,996,235	39,216,225
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	1,254,265,467	687,749,318
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,751,836,253	1,343,388,015
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	32,117,198	33,439,886
Aktive afatgjata jomateriale	10	10,603	12,474
Totali i aktiveve afatgjata		32,127,801	33,452,360
Totali i aktiveve		1,783,964,054	1,376,840,375
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	115,661,815	35,664,466
Llogari të pagueshme tregtare	12	271,317,967	165,407,807
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	217,663,910	217,190,450
Detyrime tatimore	14	1,332,329	3,550,565
Parapagime të arketuara	15	720,017,039	507,631,496
Të tjera detyrime	16	172,630	27,337,123
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,326,165,690	956,781,907
Detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		1,326,165,690	956,781,907
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		39,000,000	39,000,000
Rezerva ligjore		19,570,098	17,488,822
Fitim i pashpërndarë		361,488,370	321,944,133
Fitimi i ushtrimit		37,739,896	41,625,513
Totali i kapitalit	17	457,798,364	420,058,468
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,783,964,054	1,376,840,375

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ORION sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Performancës**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	397,216,907	339,859,419
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	3,550,290	6,537,374
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(334,484,247)	(278,442,939)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	20	(324,638,866)	(266,807,904)
2) Të tjera shpenzime	21	(9,845,381)	(11,635,035)
Shpenzime të personelit	22	(18,461,064)	(16,255,490)
1) Paga dhe shpërblime		(16,228,719)	(14,323,610)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,232,345)	(1,931,880)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(2,664,940)	(2,512,328)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(684,160)	(189,435)
Shpenzime financiare		47,826	8,021
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	25	47,826	8,021
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		44,520,612	49,004,622
Fitimi/humbja para tatimit		44,520,612	49,004,622
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(6,780,716)	(7,379,109)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(6,780,716)	(7,379,109)
Fitimi/humbja e vitit		37,739,896	41,625,513
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		37,739,896	41,625,513

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ORION sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	39,000,000	17,488,822	311,784,751	30,159,382	398,432,955
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					-
Fitimi / Humbja e vitit				41,625,513	41,625,513
Transferim në rezerva			10,159,382	(10,159,382)	-
Dividendë të paguar				(20,000,000)	(20,000,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	39,000,000	17,488,822	321,944,133	41,625,513	420,058,468
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:					-
Fitimi / Humbja e vitit				37,739,896	37,739,896
Transferim në rezerva		2,081,276	39,544,237	(41,625,513)	-
Dividendë të paguar					-
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	39,000,000	19,570,098	361,488,370	37,739,896	457,798,364

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i O R I O N sh.p.k. më 25 mars 2018 dhe janë firmosur si më poshtë.


Migena Hana

Hartues i Pasqyrave Financiare




Z. Ardian Nelo
Administrator



ORION sh.p.k.
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	37,739,896	41,625,513
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,664,940	2,512,328
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	148,013,190	434,044,762
Rënie/(rritje) në inventarë	12,219,990	(22,683,220)
Rritje/(rënie) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(566,516,149)	(452,574,921)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	77,000,891	82,275,628
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	212,385,543	(170,686,352)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(76,491,699)	(85,486,262)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(1,340,381)	(2,968,447)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(1,340,381)	(2,968,447)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Të hyra nga hua afatshkurtra	79,997,349	35,645,565
Dividendë të paguar	-	(20,000,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	79,997,349	15,645,565
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,165,269	(72,809,144)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	13,203,106	86,012,250
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	15,368,375	13,203,106

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "O R I O N" shpk është regjistruar më 12 Maj 1998 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.19427 datë 12.05.1998.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ndërtimi dhe importi i materialeve të ndryshme të ndërtimit.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 39,000,000 lekë i cili zotërohet nga ortakët : Z. Ardian Nelo dhe Z. Niazi Nelo.

Administrator i Shoqërisë është Z. Ardian Nelo.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT J81715002Q. Selia qendrore e saj është në « Rugën e Kosovarëve », Pallati Orion 2, pranë Kompleksit Dinamo, Tiranë.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 27 .

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/ Lek	111.10	127.18

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike dhe teknike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Vlerë monetare në lekë</i>	<i>3,284,224</i>	<i>6,767,506</i>
Arka	5,325	8,603
Banka	3,278,899	6,758,903
<i>Vlerë monetare në valutë</i>	<i>12,084,151</i>	<i>6,435,600</i>
Arka	7,104	169,501
Banka	12,077,047	6,266,099
	15,368,375	13,203,106

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë llogari të arkëtueshme nga klientë dhe koston e punimeve të kryera së bashku me kostot shtesë të investitorit për objektet e përfunduara në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Klientë	35,873,622	38,115,986
Vlera e situacioneve me TVSH dhe kosto shtesë	418,909,488	561,260,218
	454,783,110	599,376,204

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
TVSH	-	10,078
Garanci të dhëna	280,100	280,100
Të tjera	142,966	3,552,984
	423,066	3,843,162

ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lekë)

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Inventar i imët	863,514	863,514
Mallra	26,132,721	38,352,711
	<u>26,996,235</u>	<u>39,216,225</u>

8. Parapagimet dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime	17,010,007	5,251,080
Shpenzime të shtyra	1,237,255,460	682,498,238
	<u>1,254,265,467</u>	<u>687,749,318</u>



ORION sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lekë)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Ndërtesa	Mobili dhe pajisje	Pajisje informatike dhe teknike	Mobilje dhe orendi	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2016	34,002,136	4,730,499	4,632,847	1,479,572			44,845,054
Shtesa		103,380	1,212,700	960,867	691,500		2,968,447
Nxjerrje jashtë përdorimit							-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	34,002,136	4,833,879	5,845,547	2,440,439	691,500	-	47,813,501
Shtesa		158,062	554,187			628,132	1,340,381
Nxjerrje jashtë përdorimit							-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	34,002,136	4,991,941	6,399,734	2,440,439	691,500	628,132	49,153,882
Zhvlerësimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2016	4,267,938	3,192,279	3,545,226	858,045			11,863,488
Amortizimi i vitit	1,486,710	318,602	405,875	229,790	69,150		2,510,127
Nxjerrje jashtë përdorimit							-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	5,754,648	3,510,881	3,951,101	1,087,835	69,150	-	14,373,615
Amortizimi i vitit	1,412,374	264,600	567,292	294,333	124,470		2,663,069
Nxjerrje jashtë përdorimit							-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	7,167,022	3,775,481	4,518,393	1,382,168	193,620	-	17,036,684
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2016	28,247,488	1,322,998	1,894,446	1,352,604	622,350	-	33,439,886
Gjendja më 31 dhjetor 2017	26,835,114	1,216,460	1,881,341	1,058,271	497,880	628,132	32,117,198

ORION sh.p.k.
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lekë)

10. Aktive afatgjata jomateriale

	<u>AAJM</u>	<u>TOTALI</u>
Gjendja më 1 janar 2016	37,800	37,800
Shtesa	-	-
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	37,800	37,800
Shtesa	-	-
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	37,800	37,800
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2016	23,125	23,125
Amortizimi i vitit	2,201	2,201
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	25,326	25,326
Amortizimi i vitit	1,871	1,871
Pakësime	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2017	27,197	27,197
Gjendja Neto me 31dhjetor 2016	12,474	12,474
Gjendja Neto me 31 dhjetor 2017	10,603	10,603

11. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Overdraft Societe Generale Albania	17,067	19,198
Overdraft nga Union Bank	115,644,748	35,645,268
	115,661,815	35,664,466

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë	271,317,967	165,407,807
	271,317,967	165,407,807

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj ortakëve	204,916,994	204,443,534
Dividendë për t'u paguar	12,746,916	12,746,916
	217,663,910	217,190,450

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
TVSH për t'u paguar	649,741	800,637
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	499,380	440,798
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	183,208	175,376
Tatim fitimi	-	2,133,754
	1,332,329	3,550,565

15. Parapagime të arkëtuara

Në këtë zë janë përfshirë paradhëniet e marra nga klientët për kontrata porosie për blerje apartamentesh, dyqanesh etj, gjendja e të cilave më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Parapagime të arkëtuara	720,017,039	507,631,496
	720,017,039	507,631,496

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 për kompaninë vijojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Kreditorë të tjerë	172,630	27,274,503
Paga për t'u paguar	-	62,620
	172,630	27,337,123

ORION sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat janë në Lekë)***17. Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 39,000,000 Lekë, 75 kuota zotërohen nga ortaku Ardian Nelo dhe 25 kuota nga ortaku Niazi Nelo.

Rezerva ligjore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 paraqitet në shumën 19,570,098 Lekë.
 Fitimi I pashpërndarë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 paraqitet në vlerën 361,488,370 Lekë
 (2016: 321,944,133 Lekë).
 Fitimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është 37,739,896 Lekë.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga punimet, situacionet në objekte	386,165,447	325,538,487
Të ardhura nga mbyllja e shitjeve të objekteve	11,051,460	14,320,932
	397,216,907	339,859,419

19. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	3,345,480	6,013,214
Të ardhura nga qiraja	-	524,160
Të ardhura të tjera	204,810	-
	3,550,290	6,537,374

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Materiale dhe lëndë të para të konsumuara	144,690,465	179,550,858
Punime nga të tretë	179,948,401	87,257,046
	324,638,866	266,807,904

ORION sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat janë në Lekë)***21. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Mirëmbajtje dhe riparime	810,652	788,015
Shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes së objektit	2,130,567	2,162,926
Shërbime kontabiliteti dhe financiare	1,470,000	1,410,000
Shërbime ligjore	169,510	228,420
Shërbime postare dhe telekomunikacioni	442,837	310,610
Tatime dhe taksa të ndryshme	1,569,862	1,131,326
Shërbime bankare	1,045,105	1,216,686
Blerje energji, ujë	812,418	781,426
Shpenzime kancelarie	505,048	663,650
Shpenzime transporti	35,495	116,241
Shpenzime të tjera	813,169	2,825,735
Taksa të ndryshme	40,718	-
	9,845,381	11,635,035

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	16,228,719	14,323,610
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,232,345	1,931,880
	18,461,064	16,255,490

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 27 .

23. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime amortizimi	2,664,940	2,512,328
	2,664,940	2,512,328

ORION sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat janë në Lekë)***24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Gjoba dhe dëmshpërblime	684,160	189,435
	684,160	189,435

25. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	47,826	8,021
	47,826	8,021

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	44,520,612	49,004,622
Total shpenzime të panjohura	684,160	189,435
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	45,204,772	49,194,057
Tatim fitimi @15%	6,780,716	7,379,109
	37,739,896	41,625,513

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime për dividendë	12,746,916	12,746,916
Hua afatgjatë nga ortakët	204,916,994	204,443,534
	217,663,910	217,190,450

28. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2017 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.



A handwritten signature in blue ink is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "Ndertim imp exp", "ORION SHPK", and "TIRANË ALBANIA".